

Vendim nr. 251 datë 28.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marjana Semini, Anëtare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 28.10.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 37 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: AGRON BAJRI, përfaqësuar nga avokat Juxhin Vrenozi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5421 (455), datë 22.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes. Cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, të pavarur dhe të caktuar me ligj.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi në vitin 2017 i është drejtuar Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (*IMT*) të Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë me kërkesë për heqjen e rrethimit të bërë nga dy shtetas në pronën e tij, të ndodhur në Tiranë. IMT-ja i është përgjigjur me shkrim kërkuesit se nuk mund ta zgjidhte çështjen, duke e informuar se pas verifikimeve të kryera nuk kishte konstatuar punime në proces, gjendja e objekteve, pronave e rrethimeve ishte e njëjta prej vitesh dhe konflikti i pronësisë ishte i hershëm dhe në sipërfaqe prone të mbivendosura.

2. Në këto rrethana, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, me objekt detyrimin e IMT-së të prishë rrethimin e paligjshëm në pronën e tij. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3319 (3380), datë 26.07.2017, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e IMT-së të ndërhyjë për prishjen e rrethimeve të paligjshme në pronën e kërkuesit.

3. Kundër vendimit kanë ushtruar apel IMT-ja dhe kundërapel kërkuesi. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.10.2017, me nr. 31116-05015-86-2017 të regjistrimit themeltar.

4. Në kushtet kur shqyrtimi i çështjes nuk po përfundonte në gjykatën e shkallës së dytë, kërkuesi në datën 07.02.2022 ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga gjykata e apelit dhe përshpejtimin e procedurave. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 15, datë 27.05.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

5. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Gjykata me vendimin nr. 6, datë 16.02.2023 (*vendimi nr. 6/2023*) ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Më pas kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me kërkesë për konstatimin e shkeljes së nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së për shkak të tejzgjatjes së afatit të gjyqësorisë së çështjes gjyqësore.

6. Sa i takon çështjes së themelit, Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 75, datë 01.02.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5421 (455), datë 22.12.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

7. Në datën 24.07.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 06.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta e pronës, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si rezultat i një procesi gjyqësor të parregullt, në aspektet e mëposhtme:

- 8.1. *E drejta e mbrojtjes, e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar personalisht kërkuesin për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit dhe vendimmarrjen e saj, edhe pse ka pasur në dispozicion adresën e tij të kontaktit, kutinë postare dhe numrin e telefonit. Si rezultat, kërkuesi nuk ka pasur mundësinë e paraqitjes së parashtrimeve të mëtejshme dhe as të kundërshtonte përbërjen e trupit gjykues. Gjykata e Lartë kishte detyrimin që ta njoftonte kërkuesin edhe për çështjet e ligjit të ngritura kryesisht prej saj, me qëllim që ai të paraqiste qëndrimin me shkrim. Kërkuesi ka marrë dijeni për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë vetëm pasi i ka ardhur fletë-thirrja e gjykatës së shkallës së parë për t'u paraqitur në gjykim.
- 8.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, e pavarur dhe e caktuar me ligj*, pasi dy nga tre anëtarët e Gjykatës së Lartë, kishin shqyrtuar dhe vendosur më parë rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Dy gjyqtarët e kanë cenuar njëherë besimin e kërkuesit te sistemi i drejtësisë dhe rrjedhimisht, duhet të ishin përjashtuar.
- 8.3. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi pothuajse pas 8 vjetësh çështja e kërkuesit është kthyer për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 22.12.2023, që ka vendosur mospranimin e rekursit të tij, duke pretenduar se ishte rrjedhojë e cenimit të së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe të caktuar me ligj (*kërkimi i parë*) dhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes gjyqësore të themelit (*kërkimi i dytë*). Duke mbajtur në konsideratë se shkaqet kushtetuese të dy kërkimeve janë të ndryshme, Kolegji do t’i analizojë kriteret e pranueshmërisë së tyre në mënyrë të ndarë.

A.1. Për kërkimin e parë

11. Për sa i takon kërkimit të parë të kërkuesit, Kolegji çmon se ai legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ai është palë në procesin gjyqësor, në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Në drejtim të kriterit paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, Kolegji thekson se Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij kriteri është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 54, datë 24.07.2017; nr. 77, datë 19.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të jenë shteruar të

gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprahe çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegj vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin nr. 00-2023-5421 (455), datë 22.12.2023, të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së apelit për kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Ashtu siç ka theksuar vazhdimisht Gjykata, vendimet e këtij lloji kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, nuk mund të konsiderohen si përfundimtare për efektet e gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 58 datë 23.03.2023; nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka ende mjete ligjore efektive në dispozicion për të mbrojtur të drejtat e tij kushtetuese të pretenduara si të cenuara, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë, ndaj kërkimi i tij për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk mund të merret në shqyrtim.

A.2. Për kërkimin e dytë

15. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar edhe më parë Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes gjyqësore të themelit të tij. Gjykata me vendimin nr. 6/2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për shkak të mos formimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, duke parashtruar në vendim edhe arsyet për të cilat gjyqtarët kanë mbajtur qëndrim të ndarë.

16. Lidhur me kërkesat e përsëritura, shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000 përcakton se kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, atëherë vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e çështjes së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ai

argumenton një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e pretenduar (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këto lloj rastesh merr rëndësi të analizohet thelbi i kërkesës, me qëllim për të evidentuar nëse ajo përmban ndonjë informacion, fakt ose rrethanë të re që nuk është shqyrtuar më parë nga Gjykata. Megjithatë, jo çdo fakt ose rrethanë e ndodhur pas dhënies së vendimit të Gjykatës ka rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet që kanë qëndruar në themel të vendimmarrjes së mëparshme të saj, në kuptimin që kërkesa e re të kalojë për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 57, datë 20.05.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

18. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesa për konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuesit për gjykimin e çështjes së tij brenda një afati të arsyeshëm, është marrë në shqyrtim nga Gjykata, e cila me vendimin nr. 6/2023, ka vendosur rrëzimin e saj. Duke mbajtur në konsideratë se nga koha e dhënies së vendimit, më 16.02.2023, nuk kanë ndodhur fakte të reja me rëndësi kushtetuese, në kuptimin që gjykimi i çështjes së kërkuesit ka përfunduar pa vonesa të mëtejshme në Gjykatën e Lartë, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual për këtë kërkim nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare, pasi nuk plotësohet kriteri paraprak i përcaktuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000.

19. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.